



DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI MUJOR I
SËMUNDSHMËRISË
INFEKTIVE
(Pasqyra 14 Sh)

SHTATOR, 2025

Buletini Mujoy i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) dhe bazohet në të dhënat e raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14 Sh dhe Sistemit të Informacionit të Sëmundjeve Infektive (SISI). Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat individuale të raportuara në SISI për muajin shtator 2025 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH), të cilat krahasohen nga Departamenti i Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), dhe plotësohen edhe me të dhënat e laboratorëve të referencës në ISHP. Ky raport paraqet kryesisht rastet e konfirmuara dhe në disa raste edhe rastet e dyshuara dhe të konfirmuara.

1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike gjatë muajit shtator 2025 zënë 44 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 439.4/100.000 banorë. Gastro-enteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që, në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 4.4/100.000 banorë. NJVKSH Berat dhe Kukës mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastro-enterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa bashkive për diagnozën e saktë klinike dhe konfirmimin e saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike. NJVKSH Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës dhe Shigeloze për muajin shtator 2025 në nivel kombëtar.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin shtator 2025
(Incidenca raste/100.000 banorë)


	Raste shtator 2025	Incidenca shtator 2025 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	1	0.03
Salmoneloza	14	0.49
Shigelozë (Disenteri bacilare)	9	0.31
Dizenteri amebike	0	0.00
Toksiko-infeksione alimentare	128	4.47
Gastro-enterite (etiologji e panjohur)	12426	434.11
Sëmundje diarreike në total	12578	439.42

2. Sëmundjet që parandalohen nga vaksina

2.1 Variçela

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit shtator 2025 janë raportuar në total 41 raste variçelë (incidenca 1.43/ 100.000 banorë) nga të cilat, 17 raste janë të dyshuara dhe 24 të konfirmuara klinikisht, bazuar kjo në përkufizimin e rastit për sëmundjen variçelë. Numri më i madh i rasteve është raportuar nga NJVKSH Tiranë me 23 raste. Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 4-9 vjeç me 32 raste, grafiku 1.

Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve sipas grup-moshës




2.2 Fruthi

Gjatë muajit shtator nuk është raportuar asnjë rast me fruth.

Muaj	Nr. rastesh	Incidenca
Janar	1	0.04
Shkurt	3	0.12
Mars	10	0.42
Prill	0	0
Maj	1	0.04
Qershor	0	0
Korrik	0	0
Gusht	1	0.04
Shtator	0	0

Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve të konfirmuara sipas datës së fillimit të rashit



Siç shihet dhe nga grafiku, gjatë muajit shtator nuk është konfirmuar asnjë rast me fruth.

3. Tuberkulozi pulmonar dhe ekstrapulmonar

Gjatë muajit shtator 2025 janë raportuar gjithsej 19 raste me tuberkuloz (TB), nga të cilat 16 raste janë pulmonare dhe 3 raste janë ekstrapulmonare.

Rastet e raportuara me TB pulmonar janë të konfirmuara pozitive.

Rastet pulmonare përkatësisht janë: 9 në Tiranë, 1 në Vlorë, 1 në Lezhë, 1 në Elbasan, 1 në Fier, 1 në Gjirokastrë, 1 në Berat dhe 1 në Durrës (total 16).

Rastet ekstrapulmonare përkatësisht janë: 1 në Dibër, 1 në Krujë dhe 1 në Elbasan (total 3).

Konfirmimet e tyre janë kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, si dhe për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Pothuajse të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Siç vihet re dhe nga shpërndarja e rasteve, ato me TB janë të fokusuara kryesisht në Tiranë me numër më të madh.

4. Sëmundjet zoonotike

Tabela 2. Shpërndarja e zoonozave në muajin shtator 2025, numri total i rasteve dhe
incidenca (Antraks, Brucelozë, Leptospirozë, Rikeciozë)

	Shtator (raste 2025)	Incidenca (raste/100,000) 2025
Antraks (Plasje)	0	0.00
Brucelozë	3	0.10
Leptospirozë	0	0.00


Për muajin shtator janë raportuar 3 raste Brucelozë përkatësisht: 3 në Dibër dhe 1 në Elbasan.

5. Sëmundje infektive me transmetim përmes ajrit

5.1 COVID-19 shtator 2025


Gjatë muajit shtator 2025 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 1362 raste të konfirmuara me COVID-19, dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin shtator është 56.7 raste /100000 banorë.

Grafiku 3. Shpërndarja e rasteve sipas grup-moshave, shtator 2025



Grup-mosha më e prekur për këtë muaj është grup-mosha 65-74 vjeç me 211 raste e ndjekur nga ajo 35-44 vjeç dhe 55-64 vjeç me nga 186 dhe 185 raste secila. Këtë muaj ka një rritje të rasteve të grup-moshës pediatrike që shoqërohet edhe me rritje të shtrimeve në këtë grup-moshë. Në grup-moshën 0-04 vjeç rastet e konfirmuara janë 96 nga të cilat 57 janë të shtruar në spital.

Grafiku 4. Shpërndarja e rasteve sipas bashkive, shtator 2025



Rastet janë raportuar nga pjesa më e madhe e bashkive. Numrin më të madh të rasteve e kanë bashkitë Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë etj.

Gjatë muajit shtator 2025 janë raportuar 110 raste të shtruara në spital dhe asnjë vdekje. Konfirmimi i rasteve është bërë në 93.6% (1274 raste) janë konfirmuar në laboratorët e NJVKSH-ve dhe 6.4% (88 raste) janë konfirmuar në laboratorin e ISHP-së.

5.2 Grip

Gjatë muajit shtator janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 372 raste të dyshuar me Grip, por asnjë nuk ka rezultuar pozitiv.

6. Sëmundje të tjera

Leishmania visceralis shtator 2025

Në muajin shtator 2025 është raportuar një rast i moshës pediatrike nga bashkia Tepelenë me leishmania visceralis.

Infeksioni nga Virusi i Nilit Perëndimor (VNP)

Gjatë vitit 2025 në Shqipëri janë testuar 108 persona për WNV, ku vetëm gjatë muajve qershor – shtator 2025 janë testuar 98 raste (90.7%) të dyshuar për WNV.

Gjatë periudhës qershor – shtator 2025, nga 98 rastet e testuara, vetëm 3 raste (3 %) janë konfirmuar nëpërmjet serologjisë të dyfishtë dhe PCR, ndërsa 1 rast është i mundshëm duke paraqitur vetëm një rezultat pozitiv serologjik, ndërsa 94 raste mbeten raste të dyshuara për shkak të shenjave klinike.

Rasti i parë është konfirmuar në laboratorin e ISHP-së dhe është raportuar nga shërbimi i sëmundjeve infektive në Elbasan, dhe referon udhëtime jashtë vendit. Pacienti është nga Belshi, njësi administrative Çepë, i moshës 72 vjeç dhe ka paraqitur shenja të pakta cerebrale. Aktualisht ai ka dalë nga spitali në gjendje të mirë shëndetësore.

Ndërsa rasti i dytë paraqet shenja meningeale, mosha 65 vjeç nga Kuçova, por raportuar nga Spitali i Beratit, dhe tashmë është transferuar në shërbimin e sëmundjeve infektive, QSUT.

Pacientja e klasifikuar si e mundshme është e moshës 60 vjeç, gjinia femër pa të dhëna të udhëtimit jashtë vendit, e raportuar nga NJVKSH Lezhë.

Rasti i tretë i konfirmuar është nga qyteti i Lushnjës i moshës 60 vjeç, i raportuar nga spitali infektiv QSUT. Nuk referon të ketë udhëtuar jashtë vendit.

Rastet kanë paraqitur shenja klinike si: temperaturë, ethe, dhimbje koke, pështjellime, fotofobi, konvulsione, pagjumësi, çorientim në kohë etj.

Deri më tani nuk është konfirmuar asnjë vdekje në rastet e konfirmuara apo të mundshme të infeksionit nga VNP.

